



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 334105-58937 dt. 06/12 2023

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. **10.11.2023**, ora 10:00

Mbledhjen e kryesoi: Milaim Hajdari- Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Hamit Kastrati (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Azemine Bujupi Gjoka (DD), Hamit Haxhiu (DD), Arbër Halilaj (GREEN), Florentina Elezi-Veliu (VV) si dhe Drejtor të Drejtorive Komunale.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend Dite:

1. Procesverbal i mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, i mbajtur me datën 20.10.2023.
2. Propozim Vendim për Dhënie, Mjete Financiare.
3. Propozim Vendim për formimin e panelit përgjegjës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.
4. Propozim Vendim për formimin e panelit përgjegjës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Personat me Aftësi të Kufizuara.
5. Propozim Vendim për formimin e panelit përgjegjës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi.
6. Propozim-Vendim për plotësim-ndryshim të vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
7. Raport për zbatimin e Planit të Integritetit për Komunën e Drenasit për vitin 2023.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të pranishmit, kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës.

Kryesuesi i Komunës Milaim Hajdari hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur me dt. 20.10.2023.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Milaim Hajdari hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Propozim Vendim, për Dhënien e Mjeteve Financiare.**

Arbër Halilaj- kryetari pati diskutua që nuk subvencionojmë jashtë komunës sonë, kërkoj një sqarim ma të detajuar rreth kërkesë, pse ishte dashtë të subvencionojm këtë kërkesë të ardhur nga një OJQ e komunës të Prishtinës. Faleminderit!

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- Nuk është OJQ e Prishtinës është fjala për Qendren për promovimin e drejtave të grave ku e udhëheq Kadire Tahiraj.

Azmine Bujupi- Gjoka- të njëjtën pyetje deshta me e parashtrua dhe unë kërkoj veç një sqarim, pasi që keni thënë se nuk mundem me subvencionu OJQ-të jashtë komunës së Drenasit, po thotë kryetari që ajo vepron këtu apo? Se është qendër në Prishtinë. E degën që e ka këtu.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci - Asnjë OJQ, asnjë institucion nuk mund të merr subvencionim nga komuna e Drenasit, nëse nuk vepron në Drenas. Ne e kemi Rregulloren, edhe ashtu nuk guxoj me shkelë. Këtë Rregullore e kam propozuar, e ka miratua Kuvendi për shkak të shumë arsye, sepse unë kisha presion të madh prej OJQ-ve, prej institucioneve kulturore, sportive, etj. prej jashtë Drenasit, që na vinin me kërkesa dhe këta e kemi bërë, sepse mjetet janë të Drenasit edhe investojnë veç për Drenas. Është fjala për Qendrën për Promovimin e të Drejtave të Grave, me seli në Drenas, e cila udhëhiqet nga Kadire Tahiraj.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim-Vendim për Formimin e Panelit Përgjegjës për zhvillim procedural për formimin e Komitetit Konsultativ i Komunal për Arsim, Kulture, Rini dhe SPAK.**

ndoshta jeni në njohuri, ka skadua mandati komisionit paraprakisht, ndërsa na jemi të obliguar tash me m'i shpall sipas udhëzimit me APL-së. Megjithëse kohën e fundit nuk janë pagua, e pagesa ka qenë edhe ashtu modeste, po kohën e fundit nuk janë pagua. Megjithatë me APL-ja ka rekomandua që m'i shpall, por besoj që është proceduralisht me prit.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci - Për pagesa, ka ardhë vendim prej nivelit qendror, nuk kanë me u pagua ma ata që nuk janë pjesë e institucioneve, për shembull OJQ, ANTAR, kemi me pas problem telashe, se kanë me hezitu njerëzit me ardh, po vendimin na e zbatojnë.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katër të rendit të ditës: **4. Propozim-Vendim për formimin e Panelit përzgjedhës për zhvillim procedural për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Personat me Aftësi të Kufizuara**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim-vendim për Formimin e Panelit përzgjedhës për zhvillim procedural për themelimin e Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje, Ambulancë Shëndetësi dhe Mirëqene Sociale.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Propozim-vendim për Plotësim ndryshim të vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.**

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci - Nëse një anëtar i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi nuk vjen tri mbledhje, me Rregullore e kemi detyrim me e largu edhe me plotësua. Këtu ka dy plotësime, nëse s'gabo.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Raport për Zbatimin e Planit të Integritetit për Komunën e Drenasit të vitit 2023.**

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- Për këtë raport për Planin e Integritetit, të rrezikshmërisë, jemi duke shkuar në punëtori, për dy ditë për me krye është edhe për grant të performancës, po edhe detyrim ligjor. raportin kemi me e sjell të Hënën ose të Martën pasi të bëhet materiali.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Të Ndryshme**

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- ka mundësi që do ta sjellim ndonjë pikë shtesë, ndonjë rialokim të mjeteve financiare, akoma nuk e dimë buxheti është sidomos për pagesën e banesave që i kemi shpronësua, në qoftë se arrijmë me plotësua të hyrja e buxhetit, na jena detyruar me prur me uloku buxhetin në Kuvend dhe mund ta keni një ose dy pika rreth këtyre çështjeve financiare, që na me muajt me mbërri afatin ligjor dhe me i pagur edhe mos me na u numëro masa ndej mos shpenzim.

Arbër Halilaj- Nuk e di a më lejohet te pikat për Komitete Konsultative a mundet me u formu një panel përzgjedhës tri komitete tri panele përzgjedhëse edhe tek neni dy dhe tre i propozojnë Kuvendit të Komunës listën, ndërsa te neni tre Kuvendi i Komunës shpall konkurs për anëtarët e Komitetit Konsultative.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- nëse lejohet e shpallim nëse nuk lejohet jo vazhdojmë me votim direkt

Florentina Elezi Veliu- në lidhje me raportim për pronat e dhëna në shfrytëzim përgjatë mandatit 2017-2021, domethënë me na sjell një raport për të gjitha pronat, se sa janë përmbushë kriteret me të cilat, i kanë marrë ato prona. Nëse është e mundur me shti si pikë të rendit të ditës.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- zonja Elezi, unë nuk muj me u përgatit për këtë mbledhje, mbledhjen e ardhshme, edhe ashtu e kam obligim ligjor çdo gjashtë muaj, kështu që s'muj më përgatit, se duhet me pru raportet kthyesë prej terrenit. Faleminderit!

Arbër Halilaj- Është hera e treta apo e katër që ka probleme në pagesa, e kam njoftua, na kemi njohje normal edhe private kështu në Thesar edhe kudo, edhe është gabim domethënë që ka rrjedhë prej këtui. Është njerëzore me e gabo vetëm me kërku ndjesë edhe me u marrë me përmirësimin e gabimit.

Kryesuesi i Kuvendit Milaim Hajdari- Sekretaria e Kuvendit listën e nënshkrimeve e dërgon në personel. Personeli e ka listën e pagesës, dotëthot i ka kush është në komitet në bazë të nënshkrimeve. Personeli gjithqysh me kohë i çojnë, si zakonisht, por nuk nënkupton që tash shefi i Thesarit domethënë merret drejtpërdrejtë me to, sidoqoftë personeli i ka bo vendimet, ne i dërgojmë, ato paguhen pa diskutim, do të thotë, në mënyrë retroaktive.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- Në qoftë se ato përgatiten para datës të caktuar që është me i dërgua për pagesa, para datës 10 nëse s'po gabo, Nëse është pas dhjetit, gjithmonë shkojnë një muaj mbrapa.

Azemine Bujupi Gjoka- Personeli kanë thënë që i kemi dërgua.

Kryesuesi i Kuvendit Milaim Hajdari- Atëherë, unë kërkoj ndjesë nëse këta e kanë bo at lëshim, neve na kanë thënë jemi në rregull. Unë e rregulloj problemin, veç listën me nënshkrim e dërgoj te personeli, faleminderit të gjithëve.

Pasi nuk pati diskutime të tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur mbledhjen, mbledhja përfundoj rreth orës 10:20 min .

Procesmbajtëse:



Indira Olluri Thaçi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Milaim Hajdari